



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**AUTORITETI I KONKURENCËS**  
**KOMISIONI I KONKURENCËS**

**VENDIM**

**Nr. 618, Datë 09.05.2019**

**“Për disa ndryshime në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 575, datë 03.12.2018 “Për hapjen e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregimit të naftës bruto””**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 09.05.2019, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Për disa ndryshime në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 575, datë 03.12.2018 “Për hapjen e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregimit të naftës bruto”.

**Baza Ligjore:** Neni 9, Neni 24, shkronja (d) dhe neni 42 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi procedurën e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD në tregun e prodhimit dhe tregimit të naftës bruto,

**VËREN SE :**

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 575, datë 03.12.2018 “Për hapjen e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregimit të naftës bruto”, të ndryshuar me Vendimin nr. 604, datë 21.03.2019 të Komisionit të Konkurrencës, ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers në tregun e prodhimit dhe tregimit të naftës bruto, për periudhën kohore nga 1 janari 2016 deri në 30 nëntor 2018.
2. Gjatë procedurës së hetimit paraprak janë kryer inspektime pranë ndërmarrjes nën hetim Bankers Petroleum Albania Ltd dhe ndërmarrjes ankuese Tosk Energji SHA, si dhe është kërkuar informacion nga këto ndërmarrje, nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, DPD dhe Albpetrol SHA. Nga informacioni i depozituar rezulton

se mungojnë të dhëna mbi sasitë reale të furnizuara nga Bankers për shoqëritë që operojnë në tregun e përpunimit të naftës bruto, vendase dhe të huaja.

3. Përsa më sipër si dhe në respektim të Vendimit Nr. 603, datë 21.03.2019 “Mbi zbatimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 578, datë 20.12.2018 “Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD”, pika 1 e dispozitivit, vlerësojmë të nevojshme kryerja e hetimeve shtesë për periudhën 1 janar-30 prill 2019 me qëllim kryerjen e një analize të plotë të sjelljes së ndërmarrjes nën hetim. Për realizimin e kësaj analize duhet bërë zgjatja e periudhës nën hetim, si dhe afatit të hetimit paraprak.
4. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit paraprak është i domosdoshëm për të siguruar një vendimmarrje objektive.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 42 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

#### **VENDOSI:**

1. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 575, datë 03.12.2018 “Për hapjen e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:
  - a) Pika II bëhet si vijon:

“ II. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 janari 2016 deri në 30 prill 2019”.
  - b) Pika III bëhet si vijon:

“III. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 3 Tetor 2019”.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**